



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 131/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Emine Tolaj në cilësinë kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak të manipulimit të votave gjatë procesit të numërimit, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Emine Tolaj, në cilësinë kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 31.01.2011, nga Emine Tolaj, në cilësinë kandidates për deputete në Parlamentin Kosovës nga radhët e subjektit politik AAK, me te cilën pretendohet se pas shpalljes së rezultateve të votave për deputet, ka dyshime se kandidates i janë manipuluar votat në procesin e numërimit. Parashtruesi i ankesës e lut PZAP-in që të marri si të bazuar këtë ankesë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e potencuara në ankesë janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar asnjë dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Për më tepër në ankesë nuk është theksuar se ku mund të gjenden dëshmitë për shkeljen e supozuar nga parashtruesi i ankesës. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 131/2011 më datën 02.02.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

